



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo



Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo

Publikimi teknik – TP 16

Kriteret dhe procedurat për aprovimin e shërbimeve në tokë

Material udhëzues për furnizuesit e shërbimeve në tokë dhe vetëshërbyesit

Parathënie

Në bazë të Rregullores 4/2011 për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë, Autoriteti i Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës (AAC) i bënë publike kriteret e aprovimit të çdo përdoruesi të aeroportit që dëshiron të vetëshërbehet dhe për çdo furnizues të shërbimeve në tokë në aeroporte, pa kufizime. Prandaj, qëllimi i këtij doracak është që të përshkruaj kriteret për dhënien e aprovimit për shërbime në tokë si dhe procedurat për dhënien e aprovimit të tillë nga AAC.

Kriteret janë të natyrës së sigurisë dhe asaj financiare, prandaj ky doracak është përgatitur në bashkëpunim të ngushtë mes Departamentit për aerodromet dhe Departamentit për rregullim ekonomik në kuadër të AAC-së. Këto dy departamente janë po ashtu përgjegjëse për rishikimin e të gjitha kërkesave për miratim të shërbimeve tokësore në aeroportet e Republikës së Kosovës.

Ky doracak vlen për organet menaxhuese të aeroportit të interesuara në ofrimin e shërbimeve si palë e tretë, përdoruesit e aeroportit që dëshirojnë të vetëshërbehen dhe furnizuesit e shërbimeve në tokë në aeroportet e vendosura në territorin e Republikës së Kosovës e që i nënshtrohen Rregullores nr. 04/2011 për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë.

Ky doracak është i qasshëm në uebfaqen zyrtare të AAC-së për të gjitha palët e interesuara: www.caa-ks.org.

Dritan Gjonbalaj

Drejtori i Përgjithshëm

Autoriteti i Aviacionit Civil

Lista e faqeve efektive

Kapitulli	Faqe	Nr. i rishikimit	Data efektive
Parathënie	2 nga 21	Botimi i parë	04 Korrik 2011
Lista e faqeve efektive	3 nga 21	Rishikimi 1	27 Mars 2012
Përmbajtja	4 nga 21	Botimi i parë	04 Korrik 2011
Termet dhe përkufizimet	5 nga 21	Botimi i parë	04 Korrik 2011
	6 nga 21	Botimi i parë	04 Korrik 2011
Kapitulli 1 - Fushëveprimi, qëllimi dhe kërkesat rregullatore	7 nga 21	Botimi i parë	04 Korrik 2011
	8 nga 21	Botimi i parë	04 Korrik 2011
Kapitulli 2 - Kriteret për aprovimin e shërbimeve në tokë	9 nga 21	Rishikimi 1	27 Mars 2012
	10 nga 21	Rishikimi 1	27 Mars 2012
Kapitulli 3 - Procedura për aprovimin e shërbimeve në tokë	11 nga 21	Rishikimi 1	27 Mars 2012
	12 nga 21	Rishikimi 1	27 Mars 2012
Kapitulli 4 - Mbikëqyrja e shërbimeve në tokë të aprovuara	13 nga 21	Botimi i parë	04 Korrik 2011
	14 nga 21	Botimi i parë	04 Korrik 2011
Shtojca 1 - Formulari i kërkesës	15 nga 21	Botimi i parë	04 Korrik 2011
	16 nga 21	Botimi i parë	04 Korrik 2011
	17 nga 21	Botimi i parë	04 Korrik 2011
	18 nga 21	Botimi i parë	04 Korrik 2011
	19 nga 21	Rishikimi 1	27 Mars 2012
	20 nga 21	Botimi i parë	04 Korrik 2011
	21 nga 21	Rishikimi 1	27 Mars 2012

	Emri dhe Pozita	Data	Nënshkrimi
Përgatitur nga:	Besnike Ukmata Drejtoreshë e Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Rregullim Ekonomik	22 mars 2012	
Autorizuar nga:	Besnike Ukmata Drejtoreshë, Departamenti për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Rregullim Ekonomik		
Kontrolli i Cilësisë nga:	Lendita Kika-Berisha Menaxhere, Auditim të Brendshëm dhe Kontroll të Cilësisë	23 mars 2012	
Aprovuar nga:	Dritan Gjonbalaj Drejtor i Përgjithshëm	27 mars 2012	

Përmbajtja

Parathënie.....	2
Lista e faqeve efektive	3
Përmbajtja.....	4
Termet dhe përkufizimet	5
Kapitulli 1	7
Fushëveprimi, Qëllimi dhe Kërkesat Rregullatore	7
1.1. Fushëveprimi	7
1.2. Qëllimi.....	7
1.3. Kërkesat rregullatore	7
Kapitulli 2.....	9
Kriteret për aprovimin e shërbimeve në tokë	9
Kapitulli 3.....	11
Procedura për aprovimin e shërbimeve në tokë	11
3.1 Takimi prezantues.....	11
3.2 Kërkesë për aprovim.....	11
3.3 Verifikimi i dokumenteve të dorëzuara.....	11
3.4 Dhënia e aprovimit	11
3.5 Vlefshmëria e aprovimit.....	11
3.6 Vazhdimi i aprovimit.....	12
3.7 Ndryshimi i aprovimit.....	12
Kapitulli 4.....	13
Mbikëqyrja e shërbyesve në tokë të aprovuar	13
Shtojca 1	14
Formulari.....	14
Tabela I.....	16
Tabela II	18
SHËNIME	21

Termtat dhe përkufizimet

Aeroport

nënkupton çfarëdo sipërfaqe tokësore e përshtatur në veçanti për aterrim, ngritje dhe manovrim të avionit, duke përfshirë objektet ndihmëse që këto operacione mund të përfshijnë për nevojat e trafikut të avionëve dhe shërbimeve duke i përfshirë objektet e nevojshme për të ndihmuar shërbimet komerciale ajrore;

Organ menaxhues i aeroportit

nënkupton organin i cili, në ndërlidhshmëri me aktivitetet tjera ose jo, sipas rastit, ka si objektiv të vet sipas ligjit apo rregulloreve të Republikës së Kosovës administrimin dhe menaxhimin e infrastrukturës së aeroportit, koordinimin dhe kontrollin e aktiviteteve të operatorëve të ndryshëm prezentë në aeroport ose sistemin e aeroporteve në fjalë;

Përdoruesi i aeroportit

nënkupton çdo person fizik ose juridik me përgjegjësi për bartjen e udhëtarëve, postës dhe/ose mallrave përmes ajrit deri në, ose prej aeroportit në fjalë;

Shërbimi në tokë

nënkupton shërbimet e ofruara për përdoruesit e aeroporteve, në aeroporte siç është përshkruar në Shtojcën e Rregullores nr. 04/2011;

Vetëshërbimi

nënkupton një situatë në të cilën një përdorues i aeroportit në mënyrë direkte ofron për vetveten një ose më shumë kategori të shërbimeve në tokë dhe nuk lidh asnjë kontratë të çfarëdo përshkrimi me palën e tretë për ofrimin e shërbimeve të tilla; për qëllim të këtij përkufizimi, përdoruesit e aeroportit nuk do të konsiderohen si palë e tretë mes vete kur:

- njëri mban shumicën e aksioneve në tjetrin; ose
- një organ i vetëm mban shumicën e aksioneve në secilin;

Furnizuesi i shërbimeve në tokë

nënkupton çdo person fizik ose juridik që furnizon palët e treta me një ose më shumë kategori të shërbimeve në tokë;

AAC

nënkupton Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës.

HPEA

nënkupton Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit

Kapitulli 1

Fushëveprimi, Qëllimi dhe Kërkesat Rregullatore

1.1. Fushëveprimi

Ky Doracak vlen për organin menaxhues të aeroportit, ku ofrohen shërbimet si palë e tretë, përdoruesit e aeroportit që dëshirojnë të vetëshërbehen dhe furnizuesit e shërbimeve në tokë në aeroportet e vendosura në territorin e Republikës së Kosovës e që i nënshtrohen Rregullores nr. 04/2011 për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë.

1.2. Qëllimi

Ky Doracak botohet për qëllime të përcaktimit të procedurave dhe kriterëve për dhënien e aprovimit nga AAC-ja për ofrimin e shërbimeve në tokë, sipas Nenit 11 të Rregullores nr. 04/2011 për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë.

1.3. Kërkesat rregullatore

1.3.1 Direktiva e Këshillit 96/67 e datës 15 tetor 1996 për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë në aeroportet e Komunitetit i kërkon Shteteve Anëtare që të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të hapur tregun e shërbimeve në tokë në aeroportet e mëdha. Në atë mënyrë, mund të sigurohet se kompanitë ajrore mund të zgjedhin furnizuesin e tyre të shërbimeve në tokë sipas nevojave të tyre.

1.3.2 Neni 69 i Ligjit nr. 03/L-051 mbi Aviacionin Civil thekson se shërbimi në tokë në aeroporte rregullohet sipas Direktivës së Këshillit 96/67/EC të datës 15 tetor 1996 mbi qasjen në tregun e shërbimeve në tokë në Aeroportet e Komunitetit, dhe të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Direktive. AAC-ja mund të bëjë përjashtime në përputhje me Direktivën e Këshillit 96/67/EC.

Direktiva e Këshillit 96/67/EC është zbatuar në Republikën e Kosovës përmes Nenit 69 të Ligjit mbi Aviacionin Civil dhe Rregullores nr. 4/2011 për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë. Neni 11 i Rregullores nr. 04/2011 për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë përkufizon se AAC-ja duhet të përcaktojë kriteret për dhënien e aprovimit për ofrimin e shërbimeve në tokë për kategoritë e shërbimeve në tokë ku numri i furnizuesve nuk është i kufizuar si dhe vetëshërbimet në përputhje me

Nenin 6 të së njëjtës Rregullore, sipas nevojës, për aeroportet që bien nën fushëveprimin e kësaj Rregullore.

1.3.3 Neni 11 i Rregullores nr. 04/2011 për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë përkufizon që kategoritë e shërbimeve në tokë ku numri i furnizuesve nuk është i kufizuar si dhe vetëshërbimet në përputhje me Nenin 6 të kësaj Rregullore, secili furnizues i shërbimeve në tokë dhe secili vetëshërbyes duhet të aplikojë me shkrim në AAC për aprovim, para angazhimit në aktivitetet e shërbimit në tokë në një aeroport. Dhënia e aprovimit bëhet me kërkesë të furnizuesit të shërbimeve në tokë ose përdoruesit të aeroportit që dëshiron vetëshërbime bazuar në kriteret e përcaktuara. AAC-ja duhet t'i specifikojë dhe publikojë ato kriteret.

Kapitulli 2

Kriteret për aprovimin e shërbimeve në tokë

Për të marrë aprovimin, aplikuesi duhet që së paku të plotësojë kriteret si në vijim:

- a) Të dëshmoj kompetencën dhe kapacitetin organizativ për kryerjen e punës në mënyrë të sigurt dhe me kohë në fushëveprimin e aktiviteteve të kërkuara të shërbimeve në tokë në çdo aeroport të kërkuar - të siguruar me anë të vlerësimit nga AAC-ja në bazë të kërkesave të zbatueshme kombëtare dhe ndërkombëtare dhe programit ISAGO.
- b) Të dëshmoj kompetencën teknike duke paraqitur doracakun e duhur të procedurës që përmban: strukturën organizative, personelin drejtues, përshkrimin e përgjegjësive dhe detyrave, pajisjeve në përdorim, kërkesat kualifikuese për personelin, kërkesat e trajnimit dhe planin e trajnimit, procedurat e menaxhimit të sigurisë, procedurat standarde të trajtimit përkatës, procedurat e trajnimit të veçantë në lidhje me operatorët-konsumatorët.
- c) Të ofroj politika adekuate të sigurimit nga rreziku, të vlefshme për një periudhë prej së paku një viti, varësisht nga vendndodhja e ofrimit të shërbimeve në tokë, për të mbuluar përgjegjësinë e furnizuesit për dëme të tilla që mund t'i shkaktoj një pale të tretë, gjatë kryerjes së shërbimit. Për shërbimet e renditura në shtojcën e Rregullores 4/2011, e cila dispozitë nënkupton edhe pjesën ajrore dhe pjesën tokësore, vlen kufiri i mbulimit të sigurimit për zonën ajrore. Kërkesa minimale e sigurimit do të jetë:
 - i. 2.5 milion euro për shërbimet në tokë të ofruara në pjesën tokësore
 - ii. 50 milion euro për shërbimet në tokë të ofruara në pjesën ajrore
 - iii. 250 milion euro për shërbimet e lëndëve djegëse dhe vajrave
 - i. Përdoruesit e aeroportit që dëshirojnë vetëshërbim janë të detyruar të paraqesin policën e tyre të sigurimit të korporatës
- d) Të dëshmoj aftësinë financiare – që dëshkohet nëpërmjet dorëzimit të dokumenteve të mëposhtme:
 - i. Furnizuesit e shërbimeve në tokë
 - Dëshmia që tregon se aplikuesi nuk është bllokuar për gjashtë muajt e fundit dhe/ose nuk është duke iu nënshtruar procedurës së falimentimit
 - Dëshmia që tregon se aplikuesi i ka paguar të gjitha tatimet
 - Llogaritë vjetore të audituara për dy vitet e fundit financiare (nëse zbatohet)
 - ii. Përdoruesit e aeroportit që dëshirojnë të vetëshërbehen:
 - Polica ekzistuese e sigurimit

- Licenca e vlefshme operuese, nëse kërkohet

e) Të jetë person fizik ose juridik i regjistruar në Republikën e Kosovës ose person fizik ose juridik i regjistruar për ofrimin e shërbimeve në tokë me adresën e biznesit në territorin e shteteve të HPEA-së, me degë rajonale të regjistruar në Republikën e Kosovës. Të dorëzohet certifikata e regjistrimit të biznesit e lëshuar nga autoritetet e Kosovës.

Kur aplikuesi ka përvojë të mëparshme të operimit si furnizues i shërbimeve në tokë, ose si vetëshërbyes në një shtet të HPEA-së, ai duhet të specifikojë:

- a) Shtetin/shtetet dhe aeroportin/aeroportet e përfshira duke cekur nëse aplikuesi posedon apo ka poseduar aprovimin apo autorizimin nga autoritetet kompetente kombëtare të shtetit/shteteve të tilla.
- b) Lloji i aktiviteteve të shërbimeve në tokë dhe kohëzgjatja e ofrimit të aktiviteteve të tilla.

Kapitulli 3

Procedura për aprovimin e shërbimeve në tokë

3.1 Takimi prezantues

Aplikuesi do të kërkoj takim zyrtar me AAC-në në lidhje me synimet e tij para çdo aktiviteti tjetër¹.

3.2 Kërkesë për aprovim

1. Aplikuesi dorëzon formularin e plotësuar të kërkesës së bashku me informatat/dokumentet e renditura në Kapitullin 2. Të gjitha llojet e kërkesave (fillestare, për vazhdim ose për ndryshim të aprovimit) bëhen në AAC së paku 6 javë para fillimit të operimeve pasi që është e rëndësishme që AAC-ja të ketë kohë të mjaftueshme për të trajtuar kërkesat.

Një shembull i kërkesës së formularit është paraqitur në shtojcën e këtij doracaku.

3.3 Verifikimi i dokumenteve të dorëzuara

AAC-ja verifikon dokumentet e kërkesës për saktësinë dhe mjaftueshmërinë. Në rast të mosaktësisë ose mosmjaftueshmërisë së dokumenteve, aplikuesit i kërkohet të plotësoj dokumentacionin, ose të kryej korrigjimet e nevojshme. Aplikuesi duhet t'i përgjigjet kërkesave shitesë nga AAC-ja brenda afatit të caktuar, të përcaktuara nga AAC-ja, në të kundërtën do të refuzohet kërkesa për aprovim.

3.4 Dhënia e aprovimit

Pas dorëzimit dhe verifikimit të të gjitha dokumenteve të nevojshme, AAC-ja do t'i jap aprovimin aplikuesit. Formulari i aprovimit do të përmbajë të dhëna të përgjithshme për vetëshërbyesit/furnizuesit e aprovuar të shërbimeve në tokë, si dhe aeroportet për të cilat vlen aprovimi, kategoritë e aprovuara të shërbimeve në tokë dhe data e skadimit të aprovimit.

3.5 Vlefshmëria e aprovimit

Aprovimi jepet në afat prej shtatë vitesh.

¹ Inkurajohen aplikuesit të kontaktojnë autoritetin e aeroportit për ta koordinuar procedurën e aplikimit

3.6 Vazhdimi i aprovimit

Aprovimi mund të vazhdohet për periudha pasuese të vlefshme shtatë vjeçare pas përfundimit të kënaqshëm të auditimit ose vlerësimit nga ana e AAC-së. Aplikuesi do të dorëzoj formularin e kërkesës me qëllim të vazhdimit të aprovimit. Pas pranimit të kërkesës, AAC-ja kryen auditimin apo vlerësimin. Përveç kësaj, AAC-ja do të shqyrtojë të gjitha dokumentet relevante të përcaktuara në kapitullin 2 për saktësinë dhe mjaftueshmërinë. AAC-ja do të lëshoj një raport të auditimit duke deklaruar të gjitha mospajtimet e gjetura, ndërsa krahas kësaj, aplikuesi duhet të zhvillojë një plan përkatës të veprimit korrigjues dhe ta zbatoj atë brenda periudhës së paraparë kohore në mënyrë që AAC-ja t'i përmbyll gjetjet e saja. Në rast të mosveprimit si më lartë, mund të krijohet baza për veprime detyruese të AAC-së.

Pas realizimit të suksesshëm të procedurës së përcaktuar në këtë paragraf, AAC-ja do t'i japë aprovimin e ri aplikuesit me datë të re të vlefshmërisë.

3.7 Ndryshimi i aprovimit

Aprovimi mund të ndryshohet në çdo kohë me kërkesën e poseduesit të aprovimit në mënyrë që të vendoset aeroporti i ri në tabelën e aprovimit ose të rritet/zvogëlohet fushëveprimi i shërbimit në tokë apo aktivitetet vetëshërbyese të aprovuara. Poseduesi i aprovimit duhet të paraqesë formularin e kërkesës duke deklaruar ndryshimin e dëshiruar të aprovimit. Në rastet kur ndryshimet përfshijnë shërbimet në një aeroport të ri, e tërë procedura për aprovim fillestar duhet të ndiqet për lokacionin e ri. Përndryshe, kur ndryshimi nënkupton vetëm rritjen/uljen e fushëveprimit të shërbimit në tokë apo aktiviteteteve vetëshërbyese të aprovuara, AAC-ja do të kryejë një kontroll ose vlerësim pas pranimit të formularit të kërkesës. Përveç kësaj, AAC-ja do të shqyrtojë të gjitha dokumentet relevante të përcaktuara në kapitullin 2 për saktësi dhe mjaftueshmëri. AAC-ja do të lëshoj një raport të auditimit duke deklaruar të gjitha mospajtimet e gjetura ndërsa krahas kësaj aplikuesi duhet të zhvillojë planet adekuate korrigjuese të veprimit dhe ta zbatojë atë brenda periudhës së paraparë kohore në mënyrë që AAC-ja t'i mbyll gjetjet e saja. Në rast të mosveprimit si më lartë, mund të krijohet baza për veprime detyruese të AAC-së.

Pas përfundimit me sukses të procedurës së përcaktuar në këtë paragraf, AAC-ja do t'i japë aplikuesit aprovimin e ri me fushëveprimin e ri të aprovuar të shërbimeve në tokë apo aktivitetit të vetëshërbimit ose aeroportit të ri, sipas nevojës.

Kapitulli 4

Mbikëqyrja e shërbyesve në tokë të aprovuar

AAC-ja do të verifikoj rregullisht përmbushjen e kushteve të aprovimit, duke përfshirë edhe realizimin e aktiviteteve të shërbimeve në tokë nga furnizuesi apo përdoruesi i aeroportit. AAC-ja do të kryej auditime apo vlerësime, në bazë të programit IATA-ISAGO, dhe në lidhje me sigurinë e shërbimeve të ofruara nga furnizuesi apo përdoruesi i aeroportit. Varësisht nga madhësia e kompanisë dhe fushëveprimi i aktiviteteve të shërbimeve në tokë, kjo mund të kërkojë një auditim të plotë me kohëzgjatje prej një jave apo mund të jetë një verifikim i shkurtër në rast të një fushëveprimi shumë të kufizuar të aktiviteteve me shkallë të vogël. AAC-ja do të lëshoj një raport të auditimit/vlerësimit ku deklaron të gjitha mospërputhshmëritë e gjetura, ndërsa aplikuesi njëkohësisht duhet të:

- a) Zhvilloj planet adekuate të veprimit për korigjim
- b) Verifikoj me AAC-në përshtatshmërinë e planeve të veprimit për korigjim
- c) Korigjoj mospërputhshmëritë e deklaruara sipas planit të verifikuar të veprimit për korigjim
- d) Informoj AAC-në në lidhje me veprimet korigjuese të ndërmarra, dhe
- e) Pas realizimit të këtyre më lartë, AAC-ja do të përmbyll të gjeturat e veta.

Shtojca 1

Formulari

Shembulli i formularit për aprovimin e furnizuesve të shërbimeve në tokë apo të vetëshërbyesve paraqitet në faqet në vijim. I njëjti formular vlen për aprovimin fillestar, vazhdimin apo ndryshimin e aprovimit.

Formulari është në formatin 'word' dhe është në dispozicion në uebfaqen e AAC-së në: www.caa-ks.org



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo

FORMULARI PËR APROVIM SI FURNIZUES PËR SHËRBIME NË TOKË APO SI VETËSHËRBYES

Formulari në vijim duhet të plotësohet në nivel të selisë së furnizuesit të shërbimeve në tokë ose përdoruesve të aeroportit që dëshirojnë të vetëshërbehen.

Emri i kompanisë:

(Shënoni emrin ligjor të kompanisë. Ky emërtim do të përdoret në formularin e aprovimit nga AAC-ja)

Detaje të kompanisë:

Rruga	
Qyteti	
Shteti/Provinca	
Kodi postar	
Vendi	
Telefoni	
Faksi	

Detajet kyçe kontaktuese:

Emri	
Titulli	
Telefoni	
Faksi	
GSM	
Posta elektronike	

Shërbimet në tokë do të ofrohen nga:

Organi menaxhues i aeroportit
Përdoruesit e aeroportit që dëshirojnë të vetshërbehen
Furnizues të tjerë të shërbimeve në tokë

Lloji i aprovimit:

Aprovimi fillestar	<input type="checkbox"/>
Vazhdimi i aprovimit	<input type="checkbox"/>
Ndryshimi i aprovimit	<input type="checkbox"/>

Data (dd.mm.vvvv.)	Emri i përfaqësuesit të autorizuar	Nënshkrimi

1. Lokacioni:

Emërtoni stacionin në të cilin dëshironi të ofroni shërbime në tokë	
---	--

2. Lista e shërbimeve:

Tabela I

Plotësoni katrorët e duhura për çdo nënkategori.

1. Administrimi dhe mbikëqyrja në tokë	Vetëshërbim	Shërbim për palët e treta
1.1 Shërbime përfaqësimi dhe ndërlidhëse me autoritetet lokale apo ndonjë entitet tjetër, pagesat në emër të përdoruesve të aeroportit dhe ofrimi i hapësirës për zyre për përfaqësuesit e saj.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
1.2 Kontrolli i ngarimit, lajmërimet dhe telekomunikimet.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
1.3 Përpunimi, deponimi dhe administrimi i pajisjeve njësi për ngarkim.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
1.4 Çdo shërbim tjetër mbikëqyrës para, gjatë ose pas fluturimit dhe çdo shërbim tjetër administrativ që kërkohet nga përdoruesi i aeroportit, përveç atyre të përcaktuara në 1.1, 1.2 dhe 1.3.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2. Shërbimi i udhëtarëve	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.1 Çdo lloj të asistencës në arritje, nisje, transferim ose transit udhëtarësh, duke përfshirë kontrollin e biletave dhe dokumenteve të udhëtimit, regjistrimin e bagazhit dhe bartjen e tyre deri në zonën e sortimit.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3. Përpunimi i mallrave dhe i postës	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3.1 Për mallrat: përpunimin e dokumenteve përkatëse, procedurat doganore dhe zbatimin e çdo procedure të sigurimit e dakorduar ndërmjet palëve ose kur e kërkojnë rrethanat.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3.2 Për postë: trajtimin e dokumenteve relevante dhe zbatimin e çdo procedure të sigurimit të dakorduar ndërmjet palëve ose kur e kërkojnë rrethanat.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4. Shërbimet e avionit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

4.1 Pastrimi i jashtëm dhe i brendshëm i avionit, të tualeteve si dhe shërbimet me ujë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.2 Ftohja dhe ngrohja e kabinës, largimi i borës dhe akullit, shkrija e akullit nga avioni.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.3 Ri-rregullimi i kabinës me pajisje përkatëse të kabinës dhe deponimi i këtyre pajisjeve.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5. Mirëmbajtja e avionit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5.1 Servisimet e zakonshme që kryhen para fluturimit.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5.2 Servisimet jo të zakonshme që kërkohen nga përdoruesi i aeroportit.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5.3 Ofrimi dhe administrimi i pjesëve rezervë dhe pajisjeve të përshtatshme.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5.4 Kërkesat për rezervimin e vendparkimit të përshtatshëm dhe/ose hapësirës së hangarit.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6. Operimi i fluturimeve dhe administrimi i ekuipazhit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6.1 Përgatitja e fluturimit në aeroportin e nisjes ose në çfarëdo pike tjetër.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6.2 Asistenca gjatë fluturimit, duke përfshirë ridispeçimin nëse ka nevojë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6.3 Aktivitetet pas fluturimit.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6.4 Administrimi i ekuipazhit.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7. Transporti sipërfaqësor	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7.1 Organizimi dhe bartja e ekuipazhit, udhëtarëve, bagazhit, mallrave dhe transportimi i postës ndërmjet terminaleve të ndryshme të aeroportit të njëjtë, por me përjashtim të të njëjtit transport ndërmjet avionit dhe çfarëdo pike tjetër brenda perimetrit të aeroportit të njëjtë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7.2 Organizimi dhe realizimi i transportit të veçantë me kërkesë të përdoruesit të aeroportit.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8. Shërbimet për furnizim me ushqim	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8.1 Ndërlidhje me furnizuesit dhe menaxhimin administrativ.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8.2 Deponimin e ushqimit, pijeve dhe pajisjeve të nevojshme për përgatitjen e tyre.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8.3 Pastrimi i pajisjeve të përmendura në pikën 8.2.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8.4 Përgatitja dhe dorëzimi i pajisjeve e gjithashtu furnizimin me pije dhe ushqim.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Tabela II

Plotësoni katrorët e duhur për çdo nënkategori.

1. Përpunimi i bagazhit	Vetëshërbim	Shërbim për palët e treta
1.1 Trajtimi i bagazhit në zonën e sortimit, sortimin e tij, përgatitjen e tij për nisje, ngarkimin në dhe shkarkimin prej pajisjes së dizajnuar për ta lëvizur bagazhin nga avioni në zonën e sortimit dhe anasjelltas, e gjithashtu edhe transportimin e bagazhit prej zonës së sortimit deri në zonën e marrjes së bagazhit.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2. Përpunimi i mallrave dhe postës	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.1 Trajtimi fizik i mallrave dhe postës ndërmjet terminalit ajror dhe avionit, qofshin ato në mbërritje, nisje apo transferim.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3. Përpunimi në platformë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3.1 Udhëheqja e avionit në tokë gjatë arritjes dhe nisjes.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3.2 Asistenca për avionin në lidhje me paketimin dhe ofrimin e pajisjeve të përshtatshme.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3.3 Komunikimi ndërmjet avionit dhe ofruesit të shërbimeve në pjesën ajrore.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3.4 Ngarkimi dhe shkarkimi i avionit, duke përfshirë ofrimin dhe operimin e mjeteve përkatëse, e gjithashtu edhe transportimin e ekuipazhit dhe udhëtarëve ndërmjet avionit dhe terminalit, dhe transportimin e bagazhit ndërmjet avionit dhe terminalit.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3.5 Ofrimi dhe operimi i njësive përkatëse për startimin e motorit.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3.6 Lëvizja e avionit gjatë arritjes dhe nisjes, e gjithashtu edhe ofrimi dhe operimi i pajisjeve përkatëse.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3.7 Transporti, ngarkimi dhe shkarkimi nga avioni i ushqimit dhe pijeve.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4. Shërbimi me derivate dhe vajra	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.1 Organizimi dhe ekzekutimi i operacioneve për mbushje dhe zbraze të derivateve, duke përfshirë deponimin e derivateve dhe kontrollin e cilësisë dhe sasisë së derivateve.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.2 Furnizimi i vajrave dhe fluideve tjera.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

3. Aftësia financiare:

Duhet të ofroni dëshmi të aftësisë financiare përmes dorëzimit të dokumenteve të mëposhtme:

a) Furnizuesit e shërbimeve në tokë duhet të dorëzojnë dëshmi se:

Dëshmia	Dorëzuar	Nuk është dorëzuar
Llogaria e kompanisë nuk është bllokuar brenda gjashtë muajve të fundit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Kompania nuk ka tatime të papaguara	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Llogaritë vjetore të audituara për dy vitet e fundit financiare	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

b) Përdoruesit e aeroportit që dëshirojnë të vetëshërbehen duhet të dorëzojnë:

Dëshmia	Dorëzuar	Nuk është dorëzuar	N/A
Polica ekzistuese e sigurimit nga rreziku	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Licence e vlefshme për operim (nëse ka)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

4. Përgjegjësia e sigurimit:

a) Furnizuesit e shërbimeve në tokë duhet të dorëzojnë:

Vendndodhja e shërbimeve të ofruara	Kërkesa minimale e sigurimit	Dëshmia
Ofrimi i shërbimeve në tokë në zonën tokësore	Minimum 2.5 milion Euro	<input type="checkbox"/>
Ofrimi i shërbimeve në zonën ajrore	Minimum 50 milion Euro	<input type="checkbox"/>
Ofrimi i shërbimeve për përpunimin e derivateve dhe vajrave	Minimum 250 milion Euro	<input type="checkbox"/>

b) Përdoruesit e aeroportit që dëshirojnë të vetëshërbehen duhet të dorëzojnë:

Dëshmia	Dorëzuar	Nuk është dorëzuar
Polica e sigurimit e korporatës	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

5. Doracaku për procedurat e kompanisë:

1. Bashkëngjitni dokumentet e duhura (procedurat ose doracakët) që përmbajnë:
 - a. Organogramin
 - b. Listën e stafit menaxhues
 - c. Përshkrimin e përgjegjësive dhe detyrave
 - d. Pajisjet në përdorim
 - e. Kërkesat për kualifikimin e stafit
 - f. Kërkesat përkatëse për trajnim dhe plani i trajnimit
 - g. Procedurat për menaxhimin e sigurisë
 - h. Procedurat standarde të trajnimit
 - i. Procedurat specifike të trajnimit lidhur me klientët-operatorët specifik

2. Bashkëngjitni dokumente shtesë mbështetëse, përfshirë organogramin, prezantime të kompanisë, etj.

Dëshmia	Dorëzuar	Nuk është dorëzuar
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

SHËNIME

1. Aplikuesit këshillohen që të kontaktojnë Njësinë për Shërbimet në Tokë në aeroportin ku propozojnë të angazhohen në aktivitetet e shërbimeve në tokë në mënyrë që të informohen për obligimet shtesë që duhen përmbushur nga ofruesit e shërbimeve në tokë.
2. Formulari i plotësuar për aprovim fillestar/vazhdimin/ndryshimin e aprovimit duhet të shoqërohet me tarifën e aplikueshme.